



HEKURUDHAT E KOSOVËS

U D H Ë Z I M

**MBI PROCEDURAT E KALKULIMIT TË
TRANSPORTIT TË MALLRAVE**

FUSHË KOSOVË

Qershor 2015

Në bazë të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Kooperative për NP, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A në Mbledhjen nr. 55, të mbajtur më 30.06.2015, miraton këtë:

U D H Ë Z I M

MBI PROCEDURAT E KALKULIMIT TË TRANSPORTIT TË MALLRAVE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Në këtë Udhëzim përshkruhen procedurat e mënyrës së llogaritjes – kalkulimit për transportin e realizuar të mallrave si dhe kalkulimin e shërbimeve shtesë të transportit të mallrave në Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS - SH.A.

Neni 2

Fusha e veprimit

Ky udhëzim iu shërben sektorëve të posaçëm të Kompanisë të cilët janë kompetent në realizimin e kalkulimit të të hyrave nga transporti i mallrave.

Neni 3

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim kanë këtë kuptim:

CIM – është fletëngarkesë ndërkombëtare e cila përcjell mallin nga stacioni i nisjes deri te stacioni destinuar.

Libri K - 254 – është libri i evidentimit të dërgesave në arritje.

Libri K – 117 – është libri i evidentimit të dërgesave në dalje.

Formulari Vag- 65 – është formular në të cilin regjistrohen të gjithë vagonët në hyrje dhe dalje ne stacionin kufitar.

Fletëngarkesa K- 501 – është fletëngarkesë vendore (e Trainkos Sh.A.) me të cilën përcillet vagoni i plotë dhe vagoni privat i zbrazët prej stacionit të nisjes deri në stacionin destinuar.

Formulari K – 93 - është formular (regjistri i dorëzimit) me të cilin bëhet pranim/dorëzimi i vagonëve prej një stacioni në stacionin tjetër.

Railquest – është kërkesë për realizimin e transportit të mallrave e cila dërgohet nga organizatori i transportit te Hekurudhat në të cilat do të realizohet ai transport.

DUD-i doganor – Dokument Unik Doganor i cili përdoret për qëllime të zhdoganimit të mallrave.

Programi ALFA – Program financiar kompjuterik i dizajnuar për korporata me të cilin menaxhohen financat, librat e biznesit dhe nevojat tjera të kontabilitetit.

Neni 4

Pranim dorëzimi i Trenave ndërkombëtarë të mallrave

- 4.1. Në bazë të marrëveshjeve ndërmjet Hekurudhave të Kosovës - Trainkos - SH.A. dhe Hekurudhave të tjera fqinje përcaktohet mënyra se si dhe në cilin stacion bëhet pranim-dorëzimi i trenave të mallrave.
- 4.2. Varësisht nga marrëveshja, në stacionin e përcaktuar për pranim-dorëzim të trenave të mallrave Hekurudhat e Kosovës –TRAINKOS - Sh.A. vendos zyrtarin e saj (komercialistin) i cili bënë pranim-dorëzimin teknik dhe komercial të trenit.

Neni 5

Procedura e arritjes së dërgesave me dokumentacion nga transporti ndërkombëtar

- 5.1. Secili tren i mallrave arrin së bashku me dokumentacionin përcjellës të dërgesave – fletëngarkesën CIM.
- 5.2. Zyrtari – komercialisti, kontrollon dokumentacionin përcjellës të trenit, në bazë të cilit pranohet treni ndërkombëtar bashkë me transportin, llojin, sasinë dhe destinacionin e mallit. Pas verifikimit të dokumentacionit bëhet fotokopjimi në katër (4) kopje, vendoset në zarf të mbyllur, ky dokumentacion në mënyrë obliguese duhet të dërgohet tek Doganat e Kosovës, Kalkulantët në stacionin për llogaritje-kalkulim, Pranuesin e mallit si dhe një kopje duhet të mbetet në arkivin e këtij stacioni.

5.3. Në stacionin e parë brenda kufirit bëhet pranim - dorëzimi teknik dhe komercial i trenit nga zyrtari - komercialisti i cili barazon vagonët me dokumentacione dhe bënë evidentimin e tyre në librat e stacionit: libri K-254, libri K-117, formularin Vag-65. Po ashtu në bazë të CIM – it përpilon fletëngarkesën vendore, K-501 për stacionin e destinuar.

5.4. Fletëngarkesa vendore K-501 përbehet prej 5 kopjeve të njëjta, kopjet 1,2,3 e përcjellin dërgesën deri në stacionin e destinuar (të fundit), kopja 4 dorëzohet tek kalkulanti ndërsa kopja 5 mbetet në dosjen e stacionit. Originalin e fletëngarkesës K-501 (fletat me numër 1 dhe 2) e merr pranuesi i mallit (klienti). Kopja numër 2, vuloset dhe nënshkruhet nga pranuesi i mallit dhe kthehet tek kalkulanti për llogaritje, kopja numër 3 mbetet në dosje tek stacioni i fundit të destinuar.

5.5. Me të arritur në stacionin e destinuar treni me dokumentacion përkatës, bëhet pranim - dorëzimi teknik dhe komercial i trenit nga depoisti i vagonëve.

Dokumentacioni për Doganat e Kosovës dorëzohet me regjistrin e dorëzimit K-93 të përcjellësi i trenave në stacion, ndërsa dokumentet për transportin përkatës i dorëzohen kalkulanti për llogaritje - kalkulim.

Neni 6

Llogaritja /Kalkulimi i dërgesave ndërkombëtare dhe vendore në bazë të dokumentacionit përcjellës

6.1. Kalkulanti udhëheq evidencat dhe i evidenton dërgesat e mallrave nga importi, eksporti dhe ai vendor në librat përkatës:

- a) libri i arritjes K-254,
- b) libri i ekspeditimit K-117,
- c) Pranon kërkesat për transport (RAILQUEST) për nevoja të klientëve dhe përcjell realizimin e tyre.

Llogaritja – kalkulimi i dërgesave fillon pasi që kalkulanti pranon dokumentin e zhdoganimit (DUD) nga shpediteri.

6.2. Kalkulimi bëhet nga kalkulanti për të gjitha transportet e realizuara të mallrave si dhe shërbimeve shtesë të transportit në bazë të:

1. Dokumentacionit përkatës të dërgesës - Fletëngarkesës,
2. Kontratës me klientin dhe
3. Rregullores mbi përcaktimin e kritereve për kontratë dhe kushteve të transportit me numër 02/324 të datës 29/12/2014. Përkatësisht neneve: 3,4,5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje.

Nga fletëngarkesa merren këto të dhëna: lloji i transportit, lloji i mallit, klienti, pesha, klasa tarifore, distanca në kilometra, nga kontrata me klientin: kushtet e kontratës që është nënshkruar me klientë.

Neni 7

Mënyra e Kalkulimit

Llogaritjen e dërgesave të transportit dhe shërbimeve tjera shtesë në bazë të fletëngarkesave, kontratave, tarifave dhe shënimeve tjera, kalkulanti i llogaritë në mënyrë elektronike në programin ALPHA.

Neni 8

Kontrolli i kalkulimit

8.1. Kontrolli i të gjitha kalkulimeve në transportin e mallrave që realizohet nga komercialja/kalkulantët, në baza ditor i nënshtrohet kontrollit nga zyra e kontrollit të brendshëm, përkatësisht bashkëpunëtori për kontrollin e të hyrave në TM.

8.2. Kontrolli ka për qëllim gjetjen eventuale të gabimeve teknike gjatë kalkulimit, shkeljeve eventuale të kontratës, shkeljen eventuale të Rregulloreve të aplikueshme nga Trainkos Sh.A.

8.3. Pas kontrollimit fizik dhe verifikimit se kalkulimi është bërë në rregull, bashkëpunëtori për kontrollin e të hyrave në TM, firmos me nënshkrimin e vet në fund të çdo kalkulimi dhe të njëjtin e dërgon në sektorin e Financave për faturim.

8.4. Në rastet kur bashkëpunëtori për kontrollin e të hyrave në TM, has në gabime që janë bërë gjatë llogaritjes, kalkulimi kthehet mbrapa për korrigjim tek komercialja/kalkulantët për përmirësime.

Neni 9

Procedura e pagesave me para të gatshme

9.1. Pagesa me para të gatshme aplikohet në rastet kur, Hekurudhat e Kosovës - Trainkos - Sh.A. nuk kanë kontratë transporti me klientët të cilët shfrytëzojnë shërbimet e transportit me hekurudhë.

9.2. Në këto raste kalkulanti bënë kalkulimin e transportit apo shërbimeve shtesë dhe kalkulimin bashkë me fletëngarkesë i'a dorëzon klientit. Klienti duhet të bëjë pagesën në Bankë dhe të sjell dëshminë e pagesës së Bankës tek kalkulanti para se të bëjë tërheqjen e mallit nga Hekurudha.

9.3. Pasi që të kryhet pagesa Kalkulanti këtë fletëpagesë e bashkëngjit te kalkulimi dhe e dorëzon për kontrollim siç e parasheh neni 8 i këtij udhëzimi.

Në rastet kur është festë apo nuk është ditë pune në Banka, kalkulanti përveç kalkulimit mund të pranoj edhe pagesat nga klientët për shpenzimet e kalkuluara.

Në ditën pasuese që Banka punon, Kalkulanti duhet të bëjë pagesat në Bankë duke përsëritur procedura si në pikën 9.3.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare

Më këtë udhëzim do të njoftohen: Sektori i Transportit të Mallrave, Njësia e Komerciales, Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit, Departamenti i Financave, Kalkulantët në Miradi, Sektori i Marketingut.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas aprovimit nga Bordi i Drejtorëve dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës –Trainkos Sh.A.

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi shfuqizohet Udhëzimi i mëparshëm.



Hestet Cakolli
Kryesues i Bordit të HK-Trainkos- SIA.